

L I G J
Nr.7994, datë 14.9.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7681, DATË 4.3.1993 “PËR ADMINISTRIMIN E
TATIMEVE DHE TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7681, datë 4.3.1993 “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Organet tatimore janë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe organet e saj në komuna, bashki e rrethe që varen nga kjo drejtori.

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve varet nga ministri i Financave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1216, datë 25.9.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha